



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 13 , Datë 10 / 01 / 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 59 Regj, datë 02.08.2017, e znj.R. M¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²

K O N S T A T O I :

Në ankesën e saj znj.R. M shprehet se: *“Jetoj me një pension. Kam dhe një djalë të sëmurë mendor, sepse i vdiq gruaja dhe djali. E mbyllin në spital nga një muaj dhe e nxjerrin prapë. Jam e vetme dhe dua ndihmë nga shteti”.*

Duke qenë se ankesa kishte mangësi dhe mungesë informacioni, Komisioneri me Urdhërin nr.130, datë 06.10.2017 vendosi të dërgojë inspektorët për të marrë informacion, në banesën e ankueses, për të lehtësuar subjektin ankues meqenëse ishte në moshë dhe pjesë e komunitetit rom.

Referuar zbatimit të këtij urdhëri dhe me autorizimin me nr.1058 prot., datë 01.11.2017, me datë 03.11.2017 inspektorët u paraqitën në banesën e z.R. M. Siç pasqyrohet dhe në procesverbalin e mbajtur nga inspektorët e KMD-së, znj.M nuk ndodhej në banesë, në Lagjen nr.1, Levan, Fier. (Megjithëse ankuesja ishte lajmëruar paraprakisht me shkresë, për paraqitjen e inspektorëve pranë banesës së saj).

¹Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, me komunitetin rom të Lagjes nr.1, Levan/Fier, organizuar nga KMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Pas analizimit të ankesës u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i nuk plotëson kërkesat e parashikuara ligjore, si më poshtë vijojnë:

Në nenin 33, pika 4, gërma b), parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Së pari, ankesa e znj.R. M nuk mund të shqyrtohet nga Komisioneri, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 7, të LMD³, ky ligj siguron mbrojtje nga diskriminimi nga: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”. Znj.M në rastin konkret, sipas parashikimeve të bëra në LMD, nuk ka identifikuar dhe as nuk ankohet për një subjekt konkret që ta ketë diskriminuar dhe as e pretendon fare si fakt diskriminimin.

Së dyti, lidhur me kërkesën tuaj për ndihmë financiare nga organet shtetërore, Komisioneri ju rekomandon t’i drejtoheni me një kërkesë Këshillit Bashkiak, pranë Bashkisë Fier.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Neni 33 pikat3/c/ç, 4/b/ç e ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” citon shprehimisht se: “*ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”. Për këtë arsye, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pikat3/c/ç, 4/b/ç, dhe pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

³ Shkurtesë për “Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.R. M, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Komisioneri i rekomandon znj.R. M t’i drejtohet me një kërkesë Këshillit Bashkiak, pranë Bashkisë Fier, për dhënien e ndihmës financiare, si person në nevojë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shkaku: -